



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

*Ministria e Arsimit dhe Shkencës / Ministarstvo Obrazovanja i Nauke/ Ministry of Education,
and Science*

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Numër: 01-20

Datë: 30.06.2020

Ministri i Arsimit dhe Shkencës, në mbështetje të nenit 8, 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L -113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta zyrtare nr. 7 / 01 mars 2019), neneve 15 dhe 20 të Ligjit nr. 05/L -018 për Provimin e Maturës Shtetërore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 2 / 08 janar 2016, Prishtinë nenit 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Rregullores (QRK) nr. 06/2020 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e dt. 08.06.2020, nenit 4 të Rregullores (QRK) - nr. 07/2020 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 06/2020, dt. 16.06.2020 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së kryeministrit dhe ministrive dhe shtojcës 11 të kësaj Rregulloreje, nxjerr:

V E N D I M

Provimi i Maturës Shtetërore për nxënësit që janë regjistruar jashtë vendit

1. Provimi i Maturës Shtetërore për nxënësit e regjistruar jashtë vendit do të mbahet në afatin e parë me dt. 10 korrik 2020.
2. Nxënësit duhet paraprakisht të sjellin dëshminë e regjistrimit jashtë vendit.
3. Provimi i Maturës Shtetërore për nxënësit e regjistruar jashtë vendit do të mbahet në Prishtinë.
4. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Duke u bazuar në dispozitat e cekura më lartë si dhe në bazë të kërkesave të parashtruara nga nxënësit e regjistruar jashtë vendit që ti nënshtrohen më herët Provimit të Maturës Shtetërore për arsye të krijimit të mundësisë që me kohë ti vazhdojnë studimet në institucionet e arsimit të lartë jashtë vendit, u vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1. Anëtarëve të Komisionit,
2. Kabinetit të Ministrit/ MASH;
3. Zyrës së SP/MASH;
4. Divizionit për SCSVL;
5. Arkivit/MASH.

